



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2025/0120

Paneli Shqyrtues, i emëruar Organi Shqyrtues Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërje nga panelisti individual, Isa Hasani, duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) “Gentian Sakaj” B.I., kundër Vendimin për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit të “POLICIA E KOSOVËS” në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizim me Antifriz dhe Ujë të Xhamave për Automjetet e PK-së” me numër të prokurimit 214-24-13297-1-2-1, me 02/05/2025, mori:

Vendim

1. Aprovohet, si pjesërisht e bazuar ankesa e OE “Gentian Sakaj” B.I. me nr. 2025/0120, e datës 14/02/2025, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizim me Antifriz dhe Ujë të Xhamave për Automjetet e PK-së” me numër të prokurimit 214-24-13297-1-2-1., AK/Policia Kosovës.
2. Mbet në fuqi, Njoftimi mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues, për dhënie kontratës, datës 30.01.2025, AK – “Policia Kosovës” lidhur me aktivitetin e prokurimit me të dhënat si në pikën një (1) të vendimit.
3. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën, OSHP ka të drejtë të ndërmarrë masa ndaj AK për mos respektim të vendimit sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të LPP.
4. Meqenëse ankesa e OE ankues “Gentian Sakaj” B.I, aprovohet si pjesërisht e bazuar, bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës. OE ankues obligohet që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së Punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën i bëhet konfiskimi i depozitës, dhe këto mjete kalojnë Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 23/12/2024, “POLICIA E KOSOVËS” në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar B08 Njoftim për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me “Furnizim me Antifriz

dhe Ujë të Xhamave për Automjetet e PK-së” me nr. të prokurimit: 214-24-13297-1-2-1. Ndërsa me datën 30.01.2025 Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues për dhënie të kontratës. E Dyqani i Pavarur Tregtar Autopjesë "Buqa" - Prizren

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurën e hapur, lloji i kontratës: furnizim, vlera e parashikuar e kontratës: 80,000.00 €.

Me 02.02.2025, “Gentian Sakaj” B.I., ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të lartcekur të AK. Më 06.02.2025, Autoriteti Kontraktues e ka refuzuar si te pa bazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 14.02.2025, OSHP ka pranuar ankesën nga OE “Gentian Sakaj” B.I., me nr. 2025/0120 për lidhur me aktivitetin “Furnizim me Antifriz dhe Ujë të Xhamave për Automjetet e PK-së” me nr. të prokurimit 214-24-13297-1-2-1.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues “Gentian Sakaj” B.I., janë parashtruar si në vijim:

Me date 17.01.2025 kemi dorëzuar ofertën për këtë aktivitet të prokurimit, konform të gjitha kushteve dhe kriterëve të dosjes së tenderit. Me datë 30.01.2025 kemi pranuar nga AK "B42 Letër standarde për [tenderuesin] [kandidatin] e eliminuar -1". me arsyetimin se: "3. Në dosjen e tenderit të specifikat teknike është kërkuar njësia matëse litër ndërsa OE tek artikulli 2 dhe 3, Antrifriz G12 dhe G13 nuk përputhen specifikat teknike të njësia matës e cila është ofruar me kilogram nga OE, ndërsa nga njësia kërkuese është kërkuar me litër. Andaj oferta e juaj është e pa përgjegjshme" Pas lejimit të qasjes në dokumentacion tenderues me datë 31.01.2025 dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës, kemi vërejtur se Komisioni Vlerësues kundërligjshëm ka rekomanduar për kontratë Dyqani i Pavarur Tregtar Autopjesë "Buqa".

Pretendimi 1: Pas administrimit dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës, sqarojmë se OE i rekomanduar për kontratë ka dorëzuar mostrat e Ujë të xhamave, Antifriz G12 dhe Antifriz G13, ku asnjëri nga mostrat e ofruara nuk ka GARANCION të prodhuesit sipas Specifikacionit teknik të kërkuar, meqenëse OE i propozuar për kontratë nuk është prodhues është duhur të ofrohet Garancioni nga Prodhuesi.

Pretendimi 2: Bazuar në Specifikacionin Teknik të kërkuar për plotësim kriteri, OE i rekomanduar për kontratë Dyqani i Pavarur Tregtar Autopjesë "Buqa" për Antifriz G12 dhe G13 bazuar në mostrat e ofruara, për këto 2 artikuj NUK E PLOTËSON Specifikacionin Teknik sepse, mostrat e ofruara për ta përmbushur kriterin sipas kërkesës "pika minimale të qëndrueshmërisë ndaj ngrirjes duhet ta ketë artikulli - 37 gradë celisius" ndërsa sipas përshkrimit të prodhuesit këto 2 mostra të ofruara duhet të përzihen me ujë të destiluar në proporcion 50/50 për ta plotësuar këtë kriter. Bazuar në përshkrimin në mostrat e ofruara për Antifrizin G12 dhe

G13 si në foton e mësipërme, për ta arrit kriterin për temperaturën minimale prej -37 gradë celsius, këto 2 lloje të antifrizit duhet të përzihen me ujë të destiluar në proporcion 50/50, prandaj ky kriter nuk është i plotësuar nga OE i rekomanduar për kontratë sepse është kërkuar produkt deri -37 grad celsius e jo produkt që duhet të përzihet me ujë të destiluar për ta arritë temperaturën -37 gradë celsius. Për ta bërë këtë kriter të plotësueshëm ju lutem na sqaroni ju AK mënyrën e përzierjes së këtyre 2 produkteve me ujë të destiluar në masën 50/50 për ta arrit temperaturën prej -37 gradë celsius.

Pretendimi 3: Çmimi i ofertuar nga kompania jonë është për 1 litër jo për 1 kilogram, dhe ju sqarojmë se mostrat e ofruara kanë pasur qëllim për plotësimin e specifikimeve teknike për kriterin që lidhet me Garancionin dhe kriterin për Pikën Minimale -37 gradë celsius, ndërsa për paketim ju sqaroj se prodhuesi deri tani ka punuar me këtë njësi matëse (kg), dhe nëse ne do të rekomandohemi për kontratë njësia e furnizimit do të jetë me paketim 1 litër për secilin artikull. Ne si OE kemi dorëzuar deklaratën ku deklarojmë se mallrat do të jene ne përputhje me specifikimin e kërkuar, andaj bazuar në UDHËZUES Nr. 001/2023 PËR PROKURIMIN PUBLIK, ju si AK është duhur që të kërkonit informata sqaruese lidhur me këtë.

Përfundim: Bazuar në këto që i cekëm dhe sqaruam, supozojmë që AK e ka marrë vendimin padrejtësisht për ta rekomanduar për kontratë OE Dyqani i Pavarur Tregtar Autopjesë "Buqa", duke na diskriminuar neve si OE me të vetmin qëllim që ne si OE kemi ofruar mostra 1kg në vend se të ofrohen 1L dhe të mos rekomandohemi NE për kontratë. Paragrafi 1 i nenit 7 të LPP-së e parasheh qartë që "Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente. Po ashtu paragrafi 6 i nenit 7 të LPP-së e parasheh që Gjatë udhëheqjes së aktiviteteve të prokurimit, të gjitha autoritetet kontraktuese do të sigurojnë; që (vi) që tenderi i zgjedhur të përputhet me të gjitha aspektet përmbajtësore të kushteve, kritereve dhe specifikimeve përkatëse, mirëpo ju nuk i jeni përmbajtur as kësaj dispozite ligjore. Gjithashtu Autoriteti Kontraktues nuk i ka respektuar edhe dispozitat e nenit 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë. Pretendimi jonë është i bazuar në dëshmi dhe fakte të cilat lehtësisht mund të verifikohen në dosjen e tenderit të dorëzuar nga OE i rekomanduar për kontratë dhe ne si OE, prandaj kërkojmë që Vendimi për për këtë aktivitet prokurimi të anulohet dhe të aprovohet kërkesa jonë për rivlerësim të tenderit, dhe pas një vlerësimi korrekt të rekomandoni kompaninë tonë fituese pasi që supozojmë që jemi të kompletuar për këtë projekt dhe kemi qmime të tregut dhe më të ulëta se OE i rekomanduar për kontratë. Pretendimi shtesë pas refuzimit të kërkesës për rishqyrtim nga AK: AK në përgjigjen për pretendimin ankimor 2, e pranon se Antifrizi G-12 dhe G-13 (Artikulli 2 dhe 3) duhet të përzihet me ujë të destiluar 50/50 për ta arritur pikën minimale të ngrirjes -37 grad, ndërsa këto specifika nuk i kishte kërkuar me specifikacione teknike të detyrueshme në dosjen e tenderit. AK për ta përfutuar antifriz me pikën minimale të ngrirjes -37 grad, duhet të furnizohet me 8,344 litra ujë të distiluar sepse uji i zakonshëm nuk plotëson kriter. Totali i litrave që mund të porositen në këtë kategori sipas AK janë 16,688 litra. Për përfitimin e 16688 litrave antifriz duhet të porositen 8,344 litra uje te destiluar, vlere monetare: $8,344 \times 0.50 \text{ Euro} = 4,172 \text{ Euro}$. Për këtë kosto shtesë AK a duhet të rishpall tender të ri që të mund ta shfrytëzon sasinë e antifrizit të OE të propozuar për kontratë, sepse UJI I DISTILUAR fare nuk është i përfshirë si artikull në këtë tender. OE i propozuar për kontratë mostrat e dorëzuara nuk i plotësojnë specifikat teknike të detyrueshme, sipas Kërkesa 1: Operatori Ekonomik në ditën e hapjes duhet të sjell mostra për secilin artikull sipas specifikimeve teknike të dhëna në dosjen e tenderit, për ato specifikime që neve si OE na ka eliminuar.

Duke u referuar pretendimeve si më sipër) “Gentian Sakaj” B.I., konsideron se autoriteti kontraktues ka shkelur Neni 1: Qëllimi, Neni 6: Ekonomiciteti dhe Efikasiteti, Neni 7: Barazia në Trajtim/Jo-Diskriminimi

Përgjigje e AK ne kërkesën për rishqyrtim: -Autoriteti Kontraktues nuk e ka shkelur Neni 1 Qëllimi për arsyen në vijim:

Qëllimi i aktivitetit është manja e furnizimeve plotësisht sipas kërkesave të AK dhe kriteret janë përcaktuar në përputhje me qëllimin e aktivitetit të prokurimit dhe si njedhojë AK ka siguruar mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë duke përcaktuar kushtet dhe rregullat që do të zbatohen, procedurat që do të ndiqen, të drejtat që do të respektohen dhe detyrimet që do të përmbushen nga personat, operatorët ekonomik, ndërmanjet, autoritetet kontraktuese, koncesionerët e punëve dhe organet publike që zhvillojnë, përfshihen, marrin pjesë ose interesohen, në aktivitetet e prokurimit ose që përfshihen ose kanë të bëjnë me fondet dhe/ose burimet e tilla. Ky ligj gjithashtu ka për qëllim të siguroj integritetin dhe përgjegjësinë e zyrtarëve publik, nëpunësve civil dhe personave të tjerë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit duke kërkuar që, vendimet e individëve të tillë dhe baza ligjore e faktike për vendimet e tilla, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jo-diskriminim dhe me një shkallë të lart të transparencës dhe të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji. Oferta e juaj është e pa përgjegjshme për arsye në dosjen e tenderit të specifikat teknike është kërkuar njësia matëse litër ndërsa OE tek artikulli 2 dhe 3 ,Antifriz G12 dhe G13 nuk përputhen specifikat teknike të njësia matës e cila është ofruar me kilogram nga OE, ndërsa nga njësia kërkuuese është kërkuar me litër .andaj nuk plotëson specifikat teknike të ANEKSI 1. Andaj, pretendimi ankimor është i pa bazuar.

Autoriteti Kontraktues nuk e ka shkelur Neni 6 Ekonomiciteti dhe Efikasiteti Autoriteti kontraktues nuk ka bërë shkelje të Nenit 6 të LPP-se të gjitha autoritetet kontraktuese, janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit. Në këtë aktivitet të prokurimit Autoriteti kontraktues duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit fondet publike i ka përdorë në mënyrën ekonomike pasi që pasqyroi të dorëzuar për artikullin 2 dhe 3 ,Antifriz G12 dhe G13 nuk përputhen specifikat teknike të njësia matës e cila është ofruar me kilogram nga OE, ndërsa në dosjen e tenderit tek specifikat teknike është kërkuar njësia matëse litër dhe oferta e juaj është e pa përgjegjshme. Andaj pretendimi ankimor është i pa bazuar.

Autoriteti Kontraktues nuk e ka shkelur Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo- Diskriminimi Pretendimet se AK ka shkelur nenin 7 të LPP-ës nuk qëndron pasi AK, sqaron se gjatë udhëheqjes së aktivitetit të prokurimit, ku të gjithë OE pjesëmarrës në këtë aktivitet të prokurimit duke ju përfshirë edhe juve si ankesues i ka trajtuar në mënyrë të barabartë pa diskriminime dhe pa favorizime të asnjë OE, autoriteti kontraktues nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që Redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mirë të një ose më shumë operatoreve ekonomik. Oferta e juaj është e pa përgjegjshme pasi që pasqyroi të dorëzuar për artikullin 2 dhe 3 ,Antifriz G12 dhe G13 nuk përputhen specifikat teknike të njësia matës e cila është ofruar me kilogram nga OE, ndërsa në dosjen e tenderit tek specifikat teknike është kërkuar

njësia matëse litër. Andaj oferta juaj është e pa përgjegjshme. Pretendimi ankimor është i pa bazuar.

Autoriteti kontraktues do t'i trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente.

Andaj AK i ka trajtuar në mënyrë të barabartë të gjithë Operatorët Ekonomik bazuar në kërkesat teknike dhe profesionale të Dosjes së Tenderit dhe Njoftimit për Kontratë.

Gjatë udhëheqjes së këtij aktiviteti të prokurimit, AK - Polica e Kosovës do të sigurojnë; (i) pjesëmarrjen sa më të gjerë të mundshme të operatorëve të interesuar ekonomik lidhur me çmimin dhe lëndën e prokurimit; (ii) publikimin e rregullt, dërgimin dhe/ose disponueshmërinë e të gjitha njoftimeve, informacioneve dhe dokumenteve që kanë të bëjnë me aktivitetin e prokurimit në përputhje me këtë ligj; (iii) eliminimin e praktikave, kriterëve, kërkesave dhe specifikimeve teknike që diskriminojnë në favor ose kundër një ose më shumë operatorëve ekonomik; (iv) që të gjitha specifikimet teknike dhe të gjitha kërkesat për përzgjedhje dhe dhënie, duke përfshirë rëndësinë relative të secilës kërkesë dhe kriter të tillë, e dhënies të saktësohen në njoftimin e kontratës, FDT që asnjë kërkesë, kriter, specifikim që nuk është saktësuar kështu, të mos përdoret në procesin e përzgjedhjes ose dhënies, dhe (vi) që tenden i zgjedhur të përputhet me të gjitha aspektet përmbajtësore të kushteve, kriterëve dhe specifikimeve përkatëse dhe AK ka vepruar në harmoni të plotë me LPP- dhe RRUOPP- në pretendimi ankimor është i pa bazuar.

Pretendimi ankimor 1: se për artikuj 2 dhe 3 OE rekomanduar nuk ka dorëzuar garancion nga prodhuesi AK sqaron se nuk kërkesa e AK se ka qene Gradacioni për artikullin nr. 2,3 duhet të jetë minimum 5 vite kurse për artikujt tjerë me nr:1 minimum 1 vit.

Nuk është kërkuar garancion nga prodhues është kërkuar garancion nga OE dhe OE rekomanduar ka dorëzuar garancion pretendimi ankimor është i pa bazuar.

Pretendimi ankimor 2: se OE i rekomanduar nuk plotëson specifikat teknike të artikulli 2 dhe 3 Qe nuk plotëson specifikat teknike mostrat e dorëzuar nga OE i rekomanduar tek këtë dy artikuj është specifikuar se për të arritur temperaturën -37 grade celsius duhet të përziehet me ujë të distiluar në masën 50/50 .AK sqaron se nuk qëndron kjo pikë se kërkesë të specifikat teknike në dosjen e tenderi ka qene këto:

Siq po shihet prej specifikave teknike të kërkuar nuk ka qene e specifikuar në specifika teknike se për të arritur temperaturën -37 grade celsius duhet të përziehet me ujë të distiluar në masën 50/50 ,a po qe duhet mos përziehet .po ashtu kemi një deklaratë prej prodhues ku sqaron sesi duhet të behet përzieja e masës dhe është përgjegjësi e AK -se dhe kjo është në favor të AK sepse me një litër antifriz pas përziejes bëhen dy litra.

Kjo sasi prej 33600 litra është dy here me shume sasi qe AK mund të marrë me këtë kontratë dhe me këtë çmim në këtë ofertë, e qe është në favor të AK të siguri me çmimin e njëjtes sasinë prej 33600 litra antifriz.

Ndërsa me ofertën e juaj sipas çmimeve që keni ofertuar ofron vetëm sasinë prej 18000 litra antifriz i cili nuk përziehet 50/50. pretendimi ankimor është i pa bazuar.

Pretendimi ankimor 3: se gjatë implementimit të kontratës dot ju kishim furnizuar me njësinë matëse litër. AK sqaron se si pas Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës Nr.

04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 dhe nenit 60 të RREGULLORE NR.002/2024 PËR PLOTËSIMIN DHE NDRYSHIMIN E RREGULLORES NR. 001/2022 PËR PROKURIMIN PUBLIK, per kontrate mund te rekomandohet një OE qe është përgjegjshëm me çmimi me te lire ,AK sqaron ju si OE keni qenie papërgjegjshëm sepse nuk keni plotësor kriterin e kërkuar ne dosje e tenderit dhe njoftimit per kontrate.

Kërkesa 1:Operatori Ekonomik në ditën e hapjes duhet të sjell mostra për secilin artikull sipas specifikave teknike të dhëna në dosje të tenderit. Ndërsa mostrat e dorëzuar nga ana juaj nuk plotësojnë specifikat teknike te detyrueshme. pretendimi ankimor është i pa bazuar. Andaj, sipas fakteve të lartë përmendura vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve është bërë ne përputhje të plotë me Ligjin e Prokurimit Publik dhe akteve tjera ligjore.

-Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Organi Shqyrtues i Prokurimit me datë 19.02.2025 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 0120/25, ndërsa me datë 21.02.2025 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues me nr. 2025/0120 me rekomandimet si në vijim: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si pjesërisht e bazuar dhe të mbetet në fuqi vendimi i AK.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK pajtohet rreth rekomandimeve të raportit të ekspertit shqyrtuese, dhe po ashtu OE nuk pajtohet me raportin e ekspertit shqyrtues.

Lidhur me pretendimet e OE “Gentian Sakaj” B.I., - eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2025/0120 ka vlerësuar si në vijim:

Eksperti shqyrtues ka analizuar me kujdes pretendimet e ankuesit në raport me vendimin e Autoritetit Kontraktues (AK) dhe paraqet konstatimet dhe vlerësimet e tij si më poshtë:

Pretendimi Ankimor 1 Operatori Ekonomik Gentian Sakaj B.I. pretendon se Operatori Ekonomik i rekomanduar për kontratë, Dyqani i Pavarur Tregtar Autopjesë "Buqa", ka dorëzuar mostra të ujit të xhamave, antifrizit G12 dhe G13, të cilat nuk përmbajnë garancionin e prodhuesit, siç pretendohet se kërkohet në specifikimet teknike. Ankuesi thekson se, duke qenë se ky operator nuk është vetë prodhues, ishte e domosdoshme të siguronte garancionin nga prodhuesi për produktet e ofruara.

Përgjigje ndaj Pretendimit Ankimor Nr. 1 Pas shqyrtimit të dokumentacionit të tenderit në platformën e-prokurimit, eksperti shqyrtues vëren se në Aneksin 1 të Specifikimeve Teknike të Detyrueshme, Autoriteti Kontraktues (AK) ka kërkuar që:

Garancia për artikujt nr. 2 dhe 3 duhet të jetë minimum 5 vjet, ndërsa për artikullin nr. 1 minimum 1 vit.

Nga këto kërkesa nuk rezulton që është kërkuar specifikisht garancia nga prodhuesi.

Prandaj, pretendimi i ankuesit se OE i rekomanduar për kontratë nuk ka dorëzuar garancinë e prodhuesit, nuk është i bazuar në kërkesat e përcaktuara në specifikimet teknike, të përcaktuara

në Aneksin 1 të DT-së.

Pretendimi Ankimor 2 Operatori Ekonomik Gentian Sakaj B.I. pretendon se AK – Policia e Kosovës ka rekomanduar për kontratë një OE, i cili nuk përmbush specifikimet teknike për antifrizët G12 dhe G13, bazuar në mostrat e dorëzuara. Sipas ankuesit, specifikimet kërkojnë që produktet të kenë një pikë ngrirjeje minimale prej -37°C , ndërsa mostrat e ofruara kërkojnë përzierje me ujë të destiluar në raport 50/50 për të arritur këtë temperaturë.

Ankuesi thekson se kërkesa ishte për produkte që arrijnë këtë temperaturë pa përzierje shtesë, dhe kërkon sqarim nga Autoriteti Kontraktues mbi pranimin e këtyre produkteve që, sipas tij, nuk plotësojnë kriteret e kërkuara.

Përgjigje ndaj Pretendimit Ankimor Nr. 2 Eksperti shqyrtues ka analizuar në platformën e-prokurimi kërkesat e AK-së të përfshira në Aneksin 1, Specifikimet teknike të detyrueshme të DT-së dhe ka gjetur se AK nuk ka specifikuar qartë që antifrizi duhet të arrijë -37°C pa përzierje.

Në dokumentet e tenderit, është kërkuar vetëm që produkti të ketë pikën minimale të ngrirjes -37°C , pa ndonjë sqarim shtesë mbi mënyrën e arritjes së kësaj temperature.

Sipas ekspertit shqyrtues, në mungesë të një specifikimi të qartë nga AK, diskualifikimi i ofertës së OE të rekomanduar vetëm mbi bazën e përzierjes, nuk ka një bazë të qartë ligjore, pasi AK nuk ka specifikuar qartë që antifrizi duhet të arrijë -37°C . Nëse AK kishte qëllim të kërkonte antifriz që arrin -37°C pa përzierje, atëherë kjo duhej të ishte përcaktuar qartë në Specifikimet Teknike të tenderit.

Eksperti shqyrtues po ashtu sqaron se sipas LPP-së, specifikimet teknike duhet të jenë të qarta dhe të detajuara për të siguruar konkurrencë të drejtë dhe efektive. Neni 28 i këtij ligji përcakton se specifikimet teknike duhet të përshkruajnë në mënyrë të saktë kërkesat e AK-së, duke shmangur çdo referencë që mund të favorizojë një operator të caktuar ekonomik. Duke qenë se AK nuk ka përcaktuar qartë këtë kërkesë, vendimi i saj nuk përmbush në mënyrë të plotë kërkesën për qartësi dhe objektivitet, ashtu siç kërkohet nga LPP. Megjithatë në fazën në të cilën ndodhet procedura, pretendimi ankimor i ankuesit në këtë pikë konsiderohet i papabazuar.

Pretendimi Ankimor 3 Operatori Ekonomik Gentian Sakaj B.I. pretendon se oferta e tij është eliminuar padrejtësisht për shkak të ndryshimit të njësisë matëse nga litër në kilogram. Ankuesi shpjegon se çmimi i ofertuar ishte për një litër, ndërsa mostrat e dorëzuara ishin në kilogramë, pasi prodhuesi deri tani ka përdorur këtë njësi matëse. Ai thekson se, në rast të rekomandimit për kontratë, furnizimi do të bëhej me paketim prej një litri për secilin artikull, në përputhje me kërkesat e tenderit. Ankuesi gjithashtu nënvizon se ka dorëzuar një deklaratë ku konfirmon se mallrat do të jenë në përputhje me specifikimet e kërkuara. Duke iu referuar Udhëzuesit Nr. 001/2023 për Prokurimin Publik, ankuesi argumenton se Autoriteti Kontraktues (AK) duhej të kërkonte informata sqaruese lidhur me këtë çështje, në vend që të përjashtonte ofertën e tij.

Përgjigje ndaj Pretendimit Ankimor 3 Eksperti shqyrtues ka analizuar në platformën e-prokurimit dosjen e tenderit, përfshirë Aneksin 1 të Specifikimeve Teknike të Detyrueshme si dhe Përshkrimin e Çmimeve, dhe ka vërejtur se AK ka kërkuar njësinë matëse "litër" për të gjitha produktet e tenderit.

Në Aneksin 1 të DT-së dhe në Përshkrimin e Çmimit, specifikohet qartë se:

Antifriz G-12 dhe G-13 duhet të kenë njësinë matëse "litër" dhe të pakëtohen në 1 litër.

Eksperti shqyrtues më tej sqaron se, nga dokumentacioni i tenderit, është e qartë se njësia matëse e kërkuar ka qenë "litër", dhe çdo devijim nga kjo kërkesë mund të përbëjë një arsye të ligjshme për eliminim. Sipas Rregullores Nr. 002/2024 për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, neni 19.11, "Specifikimet teknike janë kërkesa obligative, të cilat të gjithë tenderët duhet t'i përmbushin në mënyrë që të konsiderohen tenderë të përgjegjshëm. Çdo shmangie nga këto kërkesa mund të çojë në diskualifikimin e ofertës si e papërgjegjshme".

AK ka vepruar në përputhje me specifikimet teknike të tenderit, duke kërkuar që ofertat të paraqiten sipas njësisë matëse të përcaktuar dhe të mos devijojnë nga kriteret e përcaktuara në dokumentacionin e prokurimit. Prandaj, edhe në këtë pikë, pretendimi ankimor i ankuesit konsiderohet i pabazuar.

PËRFUNDIMI

Mbështetur në shqyrtimin e dokumentacionit të tenderit dhe pretendimeve të ankuesit, eksperti shqyrtues rekomandon që ankesa të konsiderohet pjesërisht e bazuar. Ankuesi pretendon shkelje të paragrafit 1 dhe paragrafit 6 të Nenit 7 të LPP, duke argumentuar mungesë transparence dhe trajtim të pabarabartë. Nga shqyrtimi i DT-së, nuk konstatohet shkelje e Nenit 7, paragrafi 1, pasi AK ka vepruar në përputhje me Rregulloren Nr. 002/2024, neni 19.11, duke eliminuar ofertën e ankuesit për devijim nga specifikimet teknike. Nuk ka dëshmi për diskriminim.

Megjithatë, sa i përket përputhshmërisë së OE të rekomanduar për kontratë, AK nuk ka përcaktuar qartë nëse temperatura minimale e ngrirjes (-37°C) duhet të arrihet pa përzierje, duke krijuar hapësirë për interpretim dhe duke ngritur nevojën për qartësi më të madhe në specifikimet teknike, në përputhje me Nenin 7, paragrafin 6. Në përputhje me të dhënat e mësipërme, ankesa duhet të konsiderohet pjesërisht e bazuar vetëm në këtë aspekt, ndërsa pretendimet e tjera nuk gjejnë mbështetje ligjore dhe konsiderohen të pabazuara.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Rregullorja e Punës së Organit të Shqyrtimit Publik, e cila gjendet e publikuar në Webfaqen e OSHP-së, me nenin 20, paragrafi 2 të Rregullores, përcakton kërkesat për Autoritetin kontraktues dhe Operatorin ekonomik, që të gjitha informatat dhe njoftimet duhen të dorëzohen dhe komunikohen përmes platformës së komunikimit publik, nëse kjo është e mundur.

Bazuar në shkresat e kësaj lënde, Paneli konsideron se lidhur me çështjen në rastin konkret, nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, në kuptim të nenit 24 paragrafit 1 të Rregullores së Punës së OSHP, duke marrë parasysh faktin që pretendimet e palëve dhe parashtrirat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritior.

Paneli shqyrtues vlerëson se Raporti i ekspertit shqyrtues, i hartuar me kërkesën e Panelit lidhur me kontestin në këtë lëndë të aktivitetit të prokurimit publik, përmban elementet qenësore të një dokumenti të tillë sikurse parashihet me dispozitën e nenit 113 lidhur me nenin 114 të LPP, sipas të cilit kërkohet nga eksperti që ta shqyrtojë gjithë dokumentacionin e prokurimit, përfshirë të gjitha pretendimet ankimore dhe të pajisë Panelin dhe të gjitha palët në konteste me një vlerësim të pavarur dhe profesional mbi aktivitetin e prokurimit dhe vlefshmërinë e pretendimeve ankimore.

Mirëpo duhet theksuar faktin ligjor se raporti i ekspertizës nuk është detyrues për Panelin shqyrtues dhe se çdo raport i tillë vlerësohet dhe/ose analizohet në kontekstin e përgjithshëm të shkresave të lëndës, fakteve të pohuara dhe të provave eventuale e tjerë, duke e pasur parasysh natyrën e shkeljeve eventuale, rrjedhën, natyrën dhe qëllimin e aktivitetit të prokurimit, prandaj fakti se në cilat raste dhe për çfarë, Paneli e mbështetet apo jo, raportin e ekspertit dhe/ose ndonjë nga rekomandimet, i takon gjyqimit të pavarur dhe profesional të tij/sajë, ashtu sikurse i adresohen këto përgjegjësi në kuptim të nenit 98, 99 lidhur me nenin 105 të Ligjit të Prokurimit Publik.

Sipas të thënave më sipër, eksperti shqyrtues i ka trajtuar në mënyrë profesionale dhe objektive të pretendimet e operatorit ekonomik ankues OE “Gentian Sakaj” B.I. Argumentimi në raportin e ekspertit shqyrtues është mjaft i detajuar, i kuptueshëm dhe i bazuar tërësisht dokumentet relevante që i referohen aktivitetit të prokurimit. Konstatimet në raportin e ekspertit shqyrtues mund të konfirmohen përmes dosjes së tenderit si dhe dokumenteve me të cilat ka kanë ofertuar tenderuesit. Raporti i ekspertit shqyrtues ka vlersuar se pretendimet e operatorit ekonomik ankues OE “Gentian Sakaj” B.I, janë pjesërisht të bazuara.

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit. Në këtë mënyrë është gjetur se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në përputhje me dispozitat ligjore për prokurimin publik dhe kërkesat e Dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e “Furnizim me Antifriz dhe Ujë të Xhamave për Automjetet e PK-së” me nr. të prokurimit: 214-24-13297-1-2-1.

Në rastin konkret nga raporti i ekspertit shqyrtues, dëshmitë e prezantuara nga operatori ekonomik ankues, dokumentet e dosjes së tenderit si dhe nga provat tjera të rastit është gjetur se pretendimet ankimore OE “Gentian Sakaj” B.I janë pjesërisht të bazuara, të paraqitura ndaj Vendimit të autoritetit kontraktues për aktivitetin e prokurimit. Duke u bazuar në gjendjen faktike të konstatuar si më sipër, Paneli Shqyrtues i ka falur besimin konstatimit dhe rekomandimit në raportin e ekspertit shqyrtues. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka gjetur se pretendimet e operatorit ekonomik ankues janë pjesërisht të bazuara. Andaj, Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit shqyrtues, ka gjetur se ankesa e Operatorit Ekonomik “Gentian Sakaj” B.I duhet aprovohet si pjesërisht e bazuar dhe mbet në fuqi Vendimi i autoritetit kontraktues, i dates, 30.01.2025, për shpërbllim me kontratë OE” “Buqa” lidhur me aktivitetin e prokurimit me “Furnizim me Antifriz dhe Ujë të Xhamave për Automjetet e PK-së” me nr. të prokurimit: 214-24-13297-1-2-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Policia e Kosovës.

Prandaj duke ju referuar nenit 104.1, të LPP, sipas të cilit kërkohet që procedura e shqyrtimit të zbatohet në mënyrë të shpejt, të ligjshme dhe efektive dhe duke i analizuar po ashtu në tërësinë e tyre shkresat e kësaj lënde në kontekstin e këtij procesi të prokurimit, Paneli nuk e konsideroi të nevojshme ta shtjelloj sërish në detaje dhe pa nevojë në këtë rast secilin pretendim ankimor, përderisa të njëjtat në mënyrë specifike janë veçuar sidomos në vendimin e atakuar të autoritetit kontraktues dhe janë analizuar dhe argumentuar pa vërejtje nga ana e këtij Paneli. Krahas tjerash, në vendimin e atakuar të autoritetit kontraktues dhe në raportet e ekspertit shqyrtues janë dhënë shpjegime të drejta po ashtu edhe lidhur me pohimet ankimore. Paneli vëren se arsyet e dhëna në vendimin e atakuar të autoritetit kontraktues janë profesionale dhe të argumentuara pa vërejtje

me prova materiale, pa nevojë që të përshkruhen sërish. Prandaj Paneli mbështet vlersimet e ekspertit shqyrtues me rekomandim, të cilët kanë shpjeguar në raportin e ekspertizës së tij me numër; 2025/0120, se gjatë zhvillimit të kësaj procedurë të prokurimit, autoriteti kontraktues ka zbatuar dispozitat ligjore të LPP-së.

Paneli shqyrtues thekson se konform nenit 1 dhe 6 të LPP, se Autoritetet kontraktuese ushtrojnë pavarësinë e tyre institucionale në procesin e prokurimit publik, mirëpo mbetet në kompetencat dhe përgjegjësitë e këtij organi shqyrtimi i pretendimeve ankimore dhe ligjshmërisë në procesin e prokurimit sipas nenit 24, paragrafi 2 i LPP cituar "Autoriteti kontraktues është përgjegjës për të siguruar që të gjitha aktivitetet e prokurimit të autoritetit të tillë kontraktues të ekzekutohen në përputhshmëri të plotë me këtë ligj" lidhur me nenin 59,1 cituar "Autoriteti kontraktues do të themelojë një Komision Vlerësues për ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e ofertave. Të gjithë anëtarët e Komisionit Vlerësues marrin përgjegjësi të plotë individuale për vlerësimin e kryer të ofertës"

Paneli shqyrtues bazuar në faktin aprovimit të pjeserishëm të ankesës të OE "Gentian Sakaj" B.I vendosi të kthehet tarifa e ankesës në shumën e deponuar nga operatori ekonomik ankues bazuar në nenin 31 par. 4 të Rregullores së Punës së OSHP.

Paneli Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Isa Hasani

Hasani

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - POLICIA E KOSOVËS**
- **OE - Gentian Sakaj B.I.**
- Arkivës së OSHP-së: